



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr. 424 prot.

Shkodër, më 19.12, 2024

V E N D I M

Nr. 279, datë 19.12.2024

"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe financiare të USH-së për vitin akademik 2023-2024"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 32 e 38; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa II, Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-ve", i ndryshuar, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, në mbledhjen e përbashkët të datës 19.12.2024

Vendosën:

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe financiare për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin e Shkodrës, "Luigj Gurakuqi", bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT
AKADEMIK**

Prof. Dr. ~~Enin~~ **GJURAJ**



KRYTAR I BORDIT

TË ADMINISTRIMIT

Prof. Asoc. Dr. **Adrian LEKA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË MËSIMORE DHE SHKENCORE PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

Shkodër, 2024

REPUBLIQUE
FEDERALE
DE SUISSE

Përmbajtja e lëndës

Baza ligjore e hartimit të raportit.....	5
Materiale tjera ndihmëse për hartimin e raportit.....	5
Dokumentet e USH të përfshira në raport.....	5
A. SENATI AKADEMIK	6
Fusha Mësimdhënia.....	6
Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies.....	6
Rritja e cilësisë së mësimdhënies duke u orientuar drejt standardeve të larta	7
Përputhshmëria e programeve të studimit dhe përgatitja e studentëve me nevojat e tregut të punës.....	7
Përmirësimi i Programeve të Studimit.....	7
Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni	12
Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja	15
Partneritete ndërkombëtare.....	15
Projekte specifike dhe rezultate konkrete.....	16
Përfitimet strategjike.....	16
Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projektet ku merr pjesë si palë aktive, ...	16
Fakulteti i Drejtësisë.	19
Fakulteti Ekonomik	19
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	19
Fakulteti i Shkencave të Edukimit	19
Fakulteti i Shkencave Natyrore	20
Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor	21
Të dhëna mbi programet e studimit.....	22
IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron,	22
IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit,	23
Përditësimi i programeve të studimit.....	25
Përditësimi i sylabuseve.....	26
Ngritja e laboratorëve të rinj dhe pasurimi i atyre ekzistues	26
Fuqizimi i praktikave profesionale.....	26
Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	26
Të dhëna në lidhje me ndryshimet në aktet e brendshme të IAL-së,	26

PUBLIC
PROPERTY
COPIERISE
COURT

Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ..	26
Parashikimin për angazhimin e personelit akademik,	27
Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet	27
Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	28
Të dhëna mbi përbërjen e Këshillit Studentor, përgjatë vitit akademik që raportohet, dhe aktivitetet e realizuara nga ana e tyre.....	28
Të dhëna mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet drejtuese të IAL-së dhe roli i tyre në këto organe vendimarrëse.....	28
Të dhëna mbi studentët.....	28
Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara nëkuadër të projekteve ndërkombëtare.....	28
B. BORDI I ADMINISTRIMIT	115

Treguesi i tabelave

Tabela Nr. 1. Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies	29
Tabela nr. 2: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit	37
Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional.....	45
Tabela nr. 4: Mbi Projekte e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim	54
Tabela nr. 5: Mbi Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara	58
Tabela nr. 6: Mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor	64
Tabela nr. 7: Mbi programet e studimit	66
Tabela nr. 8: Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë	72
Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik.....	74
Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik Fakulteti i Edukimit.....	76
Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik Fakulteti i Gjuheve te Huaja.....	79
Tabela nr. 10: Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet	81
Tabela nr. 11: Mbi përbërjen e Këshillave Studentorë	84
Tabela nr. 12: Mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet e IAL-së ...	85
Tabela nr. 13: Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve.....	86
Tabela nr. 14: Mbi numrin e studentëve të çrregjistruar dhe transferuar.....	98
Tabela nr. 29: Mbi mobilitetin e personelit akademik	110
Tabela nr. 30: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukurore.....	113
Tabela 4.2 Mbi aktivitetin shkencor të stafit akademik të USH	115

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si institucion publik, ka kryen analizën veprimtarisë së procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe gjendjen financiare gjatë vitit akademik 2023-2024, e cila paraqitet në këtë raport. Raporti paraqet në mënyrë të detajuar drejtimet në të cilat është zhvilluar veprimtaria e njësisë dhe sektorëve përbërës të këtij institucioni, që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore të institucionit. Raporti synon të evidentojë drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë e organeve vendimmarrëse hapjen e programeve të reja dhe qëndrueshmërinë e programeve tashmë në funksion, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregulloreve të programeve të studimit me kërkesat e të tregut të punës në rajonin e Shkodrës e më gjerë, ngarkesat mësimore dhe burimet e literatures, si dhe drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik të universitetit.

Baza ligjore e hartimit të raportit

Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" Nenit 32

Udhëzimi Nr. 5, dt. 19.2.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" ndryshuar me udhëzimin nr. 24 datë 21.10.2019

Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rregullore e Studimeve të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Standardet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (ASCAL, Tiranë, 2018)

Materiale tjera ndihmëse për hartimin e raportit

Udhëzuesin "Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të Arsimit të Lartë, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të ministrit të Arsimit dhe Sportit" me shkresë përcjellëse Nr. 75/5 prot date 31.07.2023 i MAS

Tabelat shoqëruese të udhëzuesit

Raporti i Monitorimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Hartuar nga Ministria e Arsimit dhe sportit Nr. Prot 4505/6 datë 25.09.2024

Dokumentet e USH të përfshira në raport

Raportet e analizave të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në departamente, materiali përmbledhës i hartuar nga dekani i fakultetit

Raportet e Vlerësimit të Brendshëm të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

Raporti i sekretarive mësimore


Raporti i zyrës së Dekanit të studentëve

Raporti i Alumnit

Raporti përfundimtar përfshin materialet e mësipërme dhe hartohet nga Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e kërkimit shkencor

A. SENATI AKADEMIK

Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.



i. Fusha Mësimdhënia

Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies

Strategjia e mësimdhënies në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (me tej USH) është ndërtuar mbi bazën e Planit Strategjik të Universitetit dhe në përputhje me objektivat kombëtare të arsimit të lartë në Shqipëri.

Qëllimet Kryesore

- ✓ Ofrimi i Arsimit të Lartë Cilësor dhe Gjithëpërfshirës:
- Sigurimi i një procesi mësimor që respekton standardet kombëtare të cilësisë.
- Krijimi i mundësive për të gjithë studentët në një mjedis transparent dhe me integritet akademik.
- Mbështetja në standardet ndërkombëtare për të garantuar një nivel të lartë akademik.
- Promovimi i kërkimit shkencor si një shtyllë kryesore e zhvillimit dhe mbështetjes së mësimdhënies.
- ✓ Kontributi në Zhvillimin Ekonomik dhe Shoqëror:
- Përgatitja e specialistëve të aftë për tregun e punës.
- Nxitja e inovacionit dhe aftësive profesionale për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit dhe vendit.

Objektivat e Programeve të Studimit që ofron USH

- ✓ Krijimi, Zhvillimi dhe Mbrojtja e Dijes:
- Transmetimi i njohurive bazuar në metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.
- Formimi i specialistëve dhe shkencëtarëve të rinj për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
- Përdorimi i metodave të reja dhe inovative për të përmirësuar përvojën e studentëve

Objektivat Strategjikë

- Përgatitja e studentëve për të konkurruar në një treg pune global përmes njohurive të thelluara dhe aftësive praktike.
- Nxitja e punës kërkimore nga pedagogët dhe studentët për të promovuar zhvillimin shkencor dhe inovacionin.
- Sigurimi i qasjes gjithëpërfshirëse në arsim për të ndihmuar zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të rajonit dhe vendit.

Strategjia e mësimdhënies së USH është një udhërrëfyes për arritjen e objektivave të larta akademike dhe shkencore, duke pasur si qëllim kryesor formimin e specialistëve të aftë për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Analiza e punës mësimore shkencore në departamente ka gjeneruar jo vetëm objektivat e përgjithshëm të mësimdhënies në universitet por dhe objektiva specifike që lidhen me programet

e studimit që ato mbulojnë. Ndër objektivat e përgjithëm në mësimdhënie mund të përmendim:

Rritja e cilësisë së mësimdhënies duke u orientuar drejt standardeve të larta

Përbushja e misionit të parë të universitetit Mësimdhënia është vlerësuar seriozisht nga gjithë departamentet në analizën e bërë për punën mësimore dhe shkencore në universitet për vitin akademik 2023-2024. Mësimdhënia cilësore është vlerësuar si procesi më i rëndësishëm që rrit dhe cilësinë e diplomave që universiteti lëshon. Mësimdhënia cilësore është objektivi kryesor që rezulton nga analiza e gjithë departamenteve të USH. Për këtë synohet:

- Ofrimi i njohurive bazë shkencore dhe aftësive specifike sipas programeve të studimit bazuar në një literaturë bashkëkohore për studentët
- Rritja në numër e stafit akademik për të mbuluar 70% të ngarkesës mësimore në të gjitha programet dhe kualifikimi i stafit akademik për të ofruar mesimdhënie sa më cilësore për studentët
- Përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në kërkimin shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe diplomave.
- Krijimi i një mjedisi mbështetës në partneritet me studentët në mësimdhënie ku ata të ndihen përgjegjës, vetë-efikasë dhe të pavarur në procesin e të nxënit. T'u sigurojë studentëve mundësi për një angazhim profesional në një shumëllojshmëri kontekstesh në përputhje me programin e studimit (vëzhgime, praktika në shkollë, ndërmarrje, biznese, klinika ligjore, klinika mjekësore, ekspedita);
- T'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre gjuhësore, kulturore dhe profesionale që të përfitojnë nga universitetet me fokus global nëpërmjet programeve të shkëmbimit të studentëve ose marrëveshjeve me partnerë në disiplina të veçanta;
- Përfshirja e teknologjisë në mësimdhënie për të ofruar një arsim të lartë cilësor dhe inovativ, duke përgatitur studentë që jo vetëm të kontribuojnë në avancimin shkencor, por të jenë gjithashtu të gatshëm për të përballuar sfidat e tregut global të punës.

Përputhshmëria e programeve të studimit dhe përgatitja e studentëve me nevojat e tregut të punës

Në këtë kuadër departamentet në analizën e tyre kanë theksuar faktin se programet e studimit bachelor dhe veçanërisht programet master shkencor dhe profesional që ato oftojnë duhet të jenë sa më afër tregut të punës dhe të ndërtohen bazuar në studimin e tregut të punës, gjë që aktualisht nuk është bërë në nivelin që kërkohet. Për të përshtatur sa më mirë nivelin e diplomave dhe përgatitjen e studentëve me tregun e punës synohet:

- Të bëhet studim i hollësishëm i tregut të punës. Nga analizat është theksuar se përshtatja dhe rinovimi i kurrikulës është i vështirë për shkak të mungesës së një studimi të thelluar të tregut të punës, duke bërë që të ulët kërkesa për studim në USH dhe kjo reflektohet në rënien e numrit të studentëve të regjistruar. Kryerja e një analize të thelluar të kërkesave të tregut për të përmirësuar përshtatjen e programeve dhe për të rritur numrin e regjistrimeve është një nga problemet më të rëndësishme që shtohet para USH.
- Reflektim i nevojave të tregut të punës dhe përfshirja e zhvillimeve të fundit në programet e studimit që fakultetet ofrojnë.
- Formimi i profesionistëve të kualifikuar që ndikojnë në përmirësimin e jetës së individëve dhe shoqërisë

Përmirësimi i Programeve të Studimit

Programet e studimit kanë qenë në qendër të vëmendjes në analizat e punës mësimore dhe shkencore të organizuara në departamente. Rishikimi i programeve të studimit në drejtim të rritjes së cilësisë së diplomave ka bërë që kjo çështje të jetë një ndër çëhtjet më të diskutuara në departamente. Ndër drejtimet kryesore ku do të përqendrohet puna e përmirësimit të programeve të studimit:

- Përshtatje e vazhdueshme e kurrikulave me trendet më të fundit me fokus në ndërtimin e njohurive bashkëkohore dhe aftësive të avancuara për t'i bërë studentët më të përgatitur për sfidat e së ardhmes
- Përmirësimi i cilësisë së kurrikulave duke përditësuar programet e studimit, përafrimi me kurrikulave me standarde të larta ndërkombëtare, shtimi i moduleve praktike duke integruar një qasje ndërdisiplinore me fokus në formimin profesional dhe akademik të studentëve.
- Nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit të nxitë rritjen e cilësisë së mësimdhënies;
- Të zbatohen standarde të larta të vlerësimit të brendshëm institucional dhe të programeve të studimit me qëllim që ato të akreditohen me kohëzgjatjen maksimale.

Nga objektivat e përgjithshme të hartuara nga Objektivat e përgjithshëm të Nga materialet e ardhura nga fakultetet janë përcaktuar objektivat specifike në bazë të programeve të studimit që ato mbulojnë:

Fakulteti Ekonomik, në përputhje me misionin dhe strategjinë e USH", ka punuar intensivisht gjatë vitit akademik 2023-2024 për të përmbushur objektivat kryesore në mësimdhënie. Përmes një qasjeje të bazuar në bashkëpunimin ndërmjet stafit akademik, studentëve dhe komunitetit të biznesit, janë arritur disa përmirësime të rëndësishme:

Objektivat e fakultetit për një mësimdhënie cilësore:

- Reflektim i nevojave të tregut të punës dhe përfshirja e zhvillimeve të fundit në fushën ekonomike në programet e studimit.
- Koordinimi mes departamenteve dhe grupeve të vlerësimit për hartimin e materialeve të nevojshme për akreditim të programeve dhe përfundim i suksesshëm i procesit të akreditimit për programet Bachelor në: Administrim-Biznes, Financë-Kontabilitet, Turizëm.
- Programet e studimit në Fakultetin Ekonomik janë krijuar dhe përditësohen në mënyrë periodike për të pasqyruar nevojat dhe kërkesat e tregut.
- Fokus në formimin profesional dhe akademik të studentëve.
- Zhvillimi i praktikave profesionale për të ndihmuar studentët në zbatimin praktik të njohurive. Përgatitja e tyre për të qenë konkurrues dhe të aftë për të përballuar sfidat profesionale.
- Përmirësimi i Programeve të Studimit
- Përshtatje e vazhdueshme e kurrikulave me trendet më të fundit ekonomike.
- Fokus në ndërtimin e njohurive bashkëkohore dhe aftësive të avancuara për t'i bërë studentët më të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Objektivat Strategjike

- FE ka implementuar një qasje të bazuar në inovacion dhe përditësim të vazhdueshëm të programeve për të ruajtur përputhjen me tregun e punës.
- Bashkëpunimi i ngushtë me sektorin ekonomik ka garantuar që programet të jenë të dizajnuara për të përmbushur nevojat aktuale të industrisë dhe biznesit.

Puna intensive në arritjen e objektivave dhe përshtatjen me tregun ka vendosur Fakultetin Ekonomik në një pozicion udhëheqës për zhvillimin profesional të studentëve dhe përmbushjen e misionit të universitetit për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të rajonit.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit (FSHE) Këtu vlen për t'u theksuar se analizat dhe diskutimet nëpër departamentet e FSHE janë fokusuar me përparësi në drejtim të rritjes së cilësisë së

mësimdhënies. Analizat nëpër departamente për punën mësimore e shkencore, viti akademik 2023-2024 janë të orientuara në procesin mësimor, realizimin e planeve mësimore të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimeve, përmirësimin e kurrikulave mësimore dhe hartimin e kurrikulave të reja. Synimet kryesore të programeve të studimit që FSHE ofron:

- Hartimi i programeve mësimore që të çojë në përgatitjen e specialistëve të aftë për tregun e punës.
- Ofrimi i njohurive bazë shkencore dhe aftësive specifike sipas programeve të studimit që fakulteti ofron.
- Nxitja e kërkimit shkencor dhe ndihma për komunitetin në zgjidhjen e problemeve.
- Përditësim i vazhdueshëm i programeve të studimit dhe rifreskimi i literaturës.
- Rritje e cilësisë së mësimdhënies përmes metodave interaktive dhe praktike.
- Organizimi i aktiviteteve studentore, si ekspozitat, seminarët dhe praktikat profesionale.
- Përfshirja e studentëve në projekte ndërkulturore dhe ekspozita.
- Mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi i brendshëm mbetet problematik në disa programe, veçanërisht në Masterin e Psikologjisë Organizative (41%) dhe Edukimin Fizik (67%).

Fakulteti ka arritje në organizimin e studentëve të cilët zhvillojnë aktivitete studentore që mbështeten nga departamentet e FSHE

- Ekspozita mbi edukimin mediatik dhe ndikimin e rrjeteve sociale.
- Ekspozita studentore vjetore dhe tematike në Galerinë e Arteve dhe ambiente të tjera.
- Bashkëpunime me organizata dhe institucione lokale për praktika profesionale.
- Sukses i FSHE ishte diplomimi i brezit të Parë Master Profesional në Mësues Muzike dhe Mësues i Artit Pamor.

Objektiva strategjike të fakultetit

- Të punohet në vazhdimësi për zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e kushteve për studentët.
- Rritja e pranisë së studentëve dhe pedagogëve në jetën e komunitetit

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) Strategjia e Fakultetit të Shkencave të Natyrës është një komponent kyç i zhvillimit të përgjithshëm të Universitetit të Shkodrës, me qëllimin për të siguruar një mësimdhënie cilësore dhe një përfshirje të madhe në kërkimin shkencor. Puna e stafit akademik të FSHN është përqendruar në rritjen e cilësisë së Mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor:

- Sigurimi i një mësimdhënieje cilësore dhe përfshirja aktive e pedagogëve dhe studentëve në kërkimin shkencor.
- Nxitja e zhvillimit të inovacionit dhe avancimit shkencor.
- Përgatitja e studentëve për të qenë konkurrues në tregun e punës dhe zhvillimi i aftësive të nevojshme që plotësojnë kërkesat e industrisë.
- Fakulteti synon përshtatjen e kurrikulave me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut të punës.
- Përshtatja e programeve të studimit për të përmirësuar cilësinë e diplomave dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e së ardhmes.
- Përshtatja e kapaciteteve dhe aftësive të studentëve për të përballuar kërkesat e tregut të punës, që janë në vazhdimësi në ndryshim.
- ✓ Zhvillimi i Projekteve Kërkimore dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit:
- Pjesëmarrja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare si një prioritet për

promovimin e inovacionit dhe zhvillimin shkencor.

- Fakulteti ka marrëveshje për shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik, organizimin e aktiviteteve shkencore dhe implementimin e projekteve të përbashkëta me universitete dhe institucione ndërkombëtare.
- Inkurajimi i vazhdueshëm i stafit akademik për kualifikime të larta, si doktorata, dhe përmirësimin e kompetencave pedagogjike për të siguruar një mësimdhënie me standartë të larta.

Misioni i mësimdhënies në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është:

- Formimi i profesionistëve të kualifikuar që ndikojnë në përmirësimin e jetës së individëve dhe shoqërisë.
- Kualifikimi i stafit akademik përmes titujve dhe gradave shkencore.
- Përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në kërkimin shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe diplomave.

Objektiva Strategjike:

- Krijimi i një strukture akademike të mirëkualifikuar.
- Aplikimi i standarteve të larta në vlerësimin e programeve të studimit.
- Hapja e programeve të reja studimi për të përmbushur kërkesat e tregut të punës.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës synon të ofrojë një arsim të lartë cilësor dhe inovativ, duke përgatitur studentë që jo vetëm të kontribuojnë në avancimin shkencor, por të jenë gjithashtu të gatshëm për të përballuar sfidat e tregut global të punës.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës, FSHSH ka pasur si objektiv kryesor realizimin e programeve të studimit për ciklet e parë, të dytë dhe të tretë. Objektivat për këtë vit akademik përfshijnë:

- Krijimi dhe zhvillimi i dijes: Duke përdorur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor për të formuar profesionistë të aftë për tregun e punës.
- Pajisja e studentëve me njohuri bazë: Përgatitja e studentëve për profesionin e tyre dhe sigurimi i një formimi të gjithanshëm shkencor dhe profesional.
- Nxitja e kërkimit shkencor: Rritja e angazhimit në kërkimin shkencor dhe promovimi i rezultateve të tij.
- Përshtatja e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës: Kjo ka për qëllim të bëjë programet më atraktive për studentët dhe t'i bëjë ata të përgatitur për sfidat profesionale.
- Programet e studimit janë të strukturuar për t'u ofruar studentëve një formim të plotë dhe të balancuar që i mundëson zhvillimin e aftësive të nevojshme për karrierën profesionale.

Disa ga arritjet e fakultetit në mësimdhënie mund të përmendim:

- Programet e studimit janë realizuar në përputhje me strukturën mësimore të përcaktuar nga Rektorati i USH, duke synuar arritjen e cilësisë dhe mbështetje në kërkimin shkencor.
- Disa pedagogë të Departamentit të Gjuhësisë dhe Letërsisë kanë pasur mundësi të zhvillojnë eksperiencë mësimore pozitive në universitete evropiane, si në Budapest, Beograd dhe Mali i Zi, përmes programit CEEPUS dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Problematika dhe sugjerime për përmirësim

- Mungesa e Studimit të Hollësishëm të Tregut të Punës Përshtatja dhe rinovimi i kurrikulës është i vështirë për shkak të mungesës së një studimi të thelluar të tregut të punës, duke bërë që diplomave të ulet kërkesa dhe të reflektohet në rënien e numrit të studentëve të regjistruar. Kryerja e një analize të thelluar të kërkesave të tregut për të përmirësuar përshtatjen e programeve dhe për të rritur numrin e regjistrimeve.

- Rinovimi i Infrastrukturës Infrastruktura fizike për mësimdhënie nuk ka ecur në të njëjtin hap me zhvillimin teknologjik, për shkak të nevojës për investime të konsiderueshme financiare.
- Perceptimi i Programit Bachelor Programi Bachelor, që kryesisht formon mësues, ka një perceptim negativ që ka ndikuar në uljen e regjistrimeve. Profesionit të mësuesit nuk është më një nga profesionet më të preferuara nga të rinjtë, gjë që ka kontribuar në uljen e numrit të studentëve të regjistruar.
- Përmirësimi i Infrastrukturës: Investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe teknologjike për të përballuar zhvillimet e shpejta teknologjike dhe për të ofruar një mjedis mësimor më të avancuar.
- Diversifikimi i Perceptimit të Programit Bachelor: Krijimi i mundësive për të diversifikuar dhe promovuar mundësitë profesionale që ofron programi Bachelor për të tërhequr më shumë studentë.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka arritur të përmbushë objektivat e tij mësimdhënës dhe shkencorë, por do të duhet të përmirësojë disa aspekte të mësimdhënies dhe të rinovojë infrastrukturën për të përmbushur më mirë kërkesat e tregut dhe për të rritur regjistrimet.

Fakulteti Gjuhëve të Huaja (FGJH) Në ciklin e parë, Fakulteti ofron katër programe studimi me objektiva për t'u ofruar studentëve aftësi dhe njohuri të thella në fusha të ndryshme gjuhësore dhe kulturore:

- përmirësimin dhe perfeksionimin e njohurive gjuhësore, ku nëpërmjet lëndëve me karakter gjuhësor studentët duhet të aftësohen që të shprehin dhe interpretojnë në gjuhë të huaj, si me gojë ashtu edhe me shkrim, koncepte, ide, ndjenja, fakte dhe mendime (në anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht)
- formimin e studentëve me njohuritë bazë shkencore të fushës së gjuhësisë, të letërsisë e kulturës së vendeve anglofone, të vendeve frankofone, të gjuhës, të letërsisë e kulturës italiane si dhe të gjuhës, letërsisë e kulturës së vendeve gjermanishtfolëse
- aftësimin e studentëve në fushën e translacionit, njohja me teorinë bazë si dhe të teknikave e strategjive që përdoren gjatë procesit të përkthimit si atij me shkrim ashtu edhe me gojë,
- aftësimin e studentëve në fushën e komunikimit ndërkulturor, të jenë të aftë të shprehin lirshëm arsyetimin llogjik si dhe të zhvillojnë mendimin kritik mbi tema të ndryshme Programet e Studimit të Ciklit të Dytë (MP)

Në ciklin e dytë, Fakulteti ofron programe master profesionale në gjuhë të huaja, qëllimi i këtyre programeve është të ofrojnë:

- Shprehi të Mirëfillta Profesionale: Përgatitja e studentëve si mësues të gjuhës së huaj me shprehi shumë të mira didaktike.
- Metodave të Mësimdhënies: Përdorimi i platformave dixhitale dhe aplikacioneve për të përmirësuar mësimdhënien, duke i mundësuar studentëve të përdorin metoda bashkëkohore të mësimdhënies.
- Praktika Mësimore: Studentët angazhohen në orë praktike të mësimdhënies për t'u përballur me realitetin e punës së mësuesit dhe për të lidhur njohuritë teorike me praktikën e mësimdhënies.
- Metodave Interaktive: Pedagogët përdorin metoda të ndryshme interaktive për të ndihmuar studentët të ndërtojnë dhe zgjerorin njohuritë mbi ato ekzistuese.
- Përditësimi i Materialeve: Programet janë përditësuar me burime dhe materiale të reja që janë implementuar në leksione dhe seminare, duke i siguruar studentëve një përvojë moderne dhe cilësore të mësimdhënies.
- Përfshirja Ndërkombëtare: Eksperiencat ndërkombëtare të pedagogëve, si pjesëmarrja në programin CEEPUS dhe bashkëpunimet me universitete evropiane, ka kontribuar në

ngritjen e cilësisë dhe diversifikimin e mësimdhënies.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Shkodrës ka arritur të ofrojë një arsimit të lartë cilësor dhe të zhvillojë një infrastrukturë akademike dhe profesionale që i mundëson studentëve të zhvillohen në nivele të larta dhe të kontribuojnë në shoqërinë dhe tregun e punës.

Në Fakultetin e Drejtësisë Stafi akademik ka punuar me përkushtim në drejtimet e mëposhtme:

- për të përmirësuar cilësinë e kurrikulave duke përditësuar programet e studimit, duke shtuar module praktike dhe duke integruar një qasje ndërdisiplinore.
- Metodatat e mësimdhënies janë moderne, interaktive, me fokus te studenti, dhe përqendrohen në njohuritë teorike dhe praktike, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale përmes bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Megjithatë, ekzistojnë sfida në ofrimin e literaturës për studentët dhe pedagogët.
- Fakulteti ka theksuar gjithashtu nevojën për përmirësime infrastrukture, si për shembull, përmirësimi i aksesit në internet, dhe sigurimi i mjeteve që do të mundësojnë përdorimin më të mirë të teknologjisë dhe metodave të reja të mësimdhënies. Aksesimi i botimeve dhe revistave juridike është gjithashtu i rëndësishëm për stafin.
- Programet e studimit janë në përputhje me misionin e Universitetit të Shkodrës (USH), i cili ka si objektiv arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie dhe vlerësimin e programeve. Këto programe janë në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e USH-së. Ato përgatitin studentët për karriera të ndryshme, përfshirë administratën publike, profesionet juridike dhe studime të mëtejshme në fushën e së drejtës. Krijimi i Klinikës së Ligjit në FD rrit angazhimin e studentëve në punë praktike ligjore.
- FD gjithashtu realizon studime për tregun e punës për programet e saj dhe monitoron vazhdimisht rezultatet e punësimit, sidomos përmes anketave dhe komunikimeve zyrtare me punëdhënësit. Programi "Master i Shkencave në Drejtësi", bazuar në kërkesën e tregut të punës lokal dhe rajonal, vazhdon të tërheqë një numër të qëndrueshëm studentësh.

FD është angazhuar për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës, duke u përballur me sfida infrastrukture dhe literaturës. Programet janë projektuar për të rritur konkurrencën e studentëve dhe për të siguruar integrimin e tyre në karrierë.

Strategjia e FSHN reflekton angazhimin për të përgatitur studentë të aftë të kontribuojnë në fushat shkencore dhe profesionale, duke mbajtur një standard të lartë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Bashkanjgjitur tabela pwrmbledhwse me materialet e sjella nga fakultetet (shtojca 1)

Tabela 1 "Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies"

ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" e ka përqendruar misionin e tij në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë krijuese si elementë kyç për përmirësimin e cilësisë akademike dhe ndikimit në shoqëri. Ky mision reflektohet edhe në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" 2022 – 2026 konkretisht " Universiteti I Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është Institucion I Arsimit të Lartë public dhe misioni I tij është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. USH I ofron mundësi të gjithë studentëve që të përfitojnë një eksperiencë edukuese me cilësi të lartë dhe të angazhohen në aktivitete kërkimore dhe krijuese, për të diplomuar student të aftë profesionalisht në mënyrë që të mund të japin kontribut me vlerë për komunitetin, vendin dhe më gjerë".

Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" 2022 - 2026

1. Përcaktimi i shtetit të përgjithshëm shkencor të universitetit
2. Përcaktimi i programit të punës dhe përfshirja e stafit në punën shkencore dhe inovative
3. Përcaktimi i strategjive të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
4. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
5. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
6. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
7. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
8. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
9. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës

Bazuar në këtë strategji, objektivat specifike të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" janë si më poshtë:

1. Përcaktimi i shtetit të përgjithshëm shkencor të universitetit
2. Përcaktimi i programit të punës dhe përfshirja e stafit në punën shkencore dhe inovative
3. Përcaktimi i strategjive të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
4. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
5. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
6. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës
7. Përcaktimi i kapaciteteve të punës dhe të punës së bashku të stafit të punës

Tabela nr. 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit (shtojca 1)

Tabela 2 reflekton përpjekjet e universiteteve për të zbatuar strategjinë e miratuar për periudhën 2022-2026, duke përfshirë rezultate konkrete dhe objektiva për të ardhmen. Kjo tabelë, në përputhje me strategjinë e zhvillimit për periudhën 2022-2026, përmbledh rezultatet dhe përpjekjet e fakulteteve për të forcuar punën kërkimore dhe inovative, duke dhënë shembuj konkretë të veprimtarive të kryera.

Fakulteti i Drejtësisë - ka përqendruar kërkimet shkencore në temat prioritare të Reformës në Drejtësi dhe Integritimit European. Këto fusha janë identifikuar si kritike për zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe përafrimin e saj me standardet e BE-së. Pedagogët e këtij fakulteti kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kanë publikuar artikuj shkencorë që adresojnë sfidat praktike dhe teorike të këtyre çështjeve. Shembull: Raporti i departamenteve për vitin akademik 2023-2024 përmend pjesëmarrjen e stafit në konferenca për reformën gjyqësore në rajon dhe ndikimin e saj në të drejtat e njeriut, ku janë prezantuar punime të mirëpritura nga komuniteti shkencor ndërkombëtar.

Fakulteti i Ekonomik - kërkimin shkencor e lidh ngushtë me prioritetet e zhvillimit ekonomik rajonal dhe kombëtar. Fakulteti ka promovuar projekte kërkimore që pasqyrojnë ndryshimet në tregjet lokale dhe globale, duke synuar përmirësimin e literaturës dhe praktikave mësimore. Shembull: Në vitin 2023-2024, disa pedagogë morën pjesë në projekte të mbështetura nga institucione ndërkombëtare, të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Një nga rezultatet kryesore ishte krijimi i një metodologjie të re për analizën e tregut të punës, e cila u prezantua në një ëorkshop të organizuar nga fakulteti në bashkëpunim me partnerë të huaj.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ndërthur kërkimin shkencor me procesin mësimor përmes metodologjive të reja dhe përfshirjes në programe ndërkombëtare si Erasmus+. Puna kërkimore

ka qenë e përqendruar kryesisht në gjuhësinë, letërsinë dhe kulturat angleze, italiane, frënge dhe të vendeve gjermanishtfolëse. Shembull: Studentët e regjistruar në programet e doktoraturës kanë realizuar kërkime të thelluara mbi ndikimin e kulturave të huaja në zhvillimin e letërsisë bashkëkohore shqiptare. Një grup studentësh dhe pedagogësh prezantuan rezultatet e tyre në Universitetin e Messinës, Itali, përmes programit Erasmus+, ku u shquan për analizat inovatore.

Fakulteti i Edukimit është fokusuar në integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien. Pedagogët kanë qenë aktivë në botime shkencore me faktor impakti, pjesëmarrje në konferenca dhe realizimin e projekteve kërkimore. Shembull: Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale raportoi një rritje në aktivitetet kërkimore për vitin 2023-2024, duke përfshirë pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare për mirëqenien e komuniteteve post-pandemike. Në Departamentin e Arteve, kërkimi shkencor shfaqet kryesisht si veprimtari krijuese artistike, ku pedagogët kanë marrë pjesë në ekspozita lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Në Departamentin e Mësuesisë, gjatë vitit akademik 2023-2024, pedagogët kanë realizuar një gamë të gjerë veprimtarish kërkimore dhe artistike, duke përbushur detyrimet kontraktuale dhe objektivat e tyre shkencore. Ndërkohë, në Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, pjesëmarrja në aktivitete kërkimore dhe botime ka qenë më e ulët krahasuar me angazhimet sportive, për shkak të natyrës së programit të studimit.

Fakulteti i Shkencave Natyrore ka përqendruar punën e tij kërkimore në forcimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore për kërkim. Pedagogët kanë marrë pjesë në projekte ndërkombëtare, duke ndarë njohuri dhe praktika të mira në fushat e shkencave ekzakte. Misioni i FSHN si edhe i gjithë strukturave të USH është përmirësimi dhe ngritja cilësore e punës kërkimore përmes vënies në jetë të metodologjive të reja dhe pjesëmarrjes aktive në programet, projektet dhe studimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Realizimi i prioritetëve kërkojnë forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture të kërkimit shkencor, të cilat arrihen përmes trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik, thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimin shkencor në fushat me interes të përbashkët.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka realizuar një punë të rëndësishme në fushën e botimeve dhe pjesëmarrjes në projekte shkencore. Pedagogët dhe studentët janë angazhuar në veprimtari që pasqyrojnë problematika të rajonit dhe të shoqërisë shqiptare. Stafi akademik i njëjësive bazë të FSHSH është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së kërkimit shkencor, si element i rëndësishëm i përmirësimit edhe të cilësisë së mësimdhënies. Kjo strategji përçohet në të gjitha departamentet dhe konkretizohet hollësisht në planifikime e zbatime specifike gjatë çdo viti akademik, me realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar; me studime e projekte për zhvillim, si dhe në veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave të gjithsecilit. Bnë synojmë të mbështesim veprimtarinë e stafit akademik për aftësimin dhe kualifikimin e tij jo vetëm në procesin e mësimdhënies, por dhe kërkimin shkencor.

Ne kërkojmë të krijohet një raport i drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke synuar ta përcojmë edhe tek studentët me qëllim që të formojmë tek ata shprehje të punës dhe të metodave kërkimore shkencore, duke i përfshirë ata edhe në grupe studimore e projekte që kanë departamentet.

Mbështetja për Kërkimin Një aspekt i rëndësishëm i strategjisë është mbështetja financiare për pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete shkencore jashtë vendit, e cila ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së kërkimeve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Politikat e universitetit për promovimin e kërkimit shkencor sigurojnë një balancë efektive midis mësimdhënies dhe kërkimit, duke përfshirë gjithashtu edhe studentët në aktivitete shkencore dhe projekte kërkimore.

Universiteti i Shkodrës ka realizuar objektivat e tij strategjike në fushën e kërkimit dhe inovacionit, duke ofruar një kontribut të rëndësishëm në përparimin akademik dhe zhvillimin shoqëror. Rezultatet konkrete tregojnë përkushtimin dhe angazhimin e stafit dhe studentëve ndaj standardeve më të larta të kërkimit.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, të dhëna mbi institucionet bashkëpunuese apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit, detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Bashkëpunimi ndërinstitucional është një nga shtyllat kryesore të strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për periudhën 2022-2026. Ky bashkëpunim synon forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore, ndërkombëtarizimin e procesit të mësimdhënies dhe rritjen e përfshirjes së studentëve në aktivitete kërkimore e profesionale. Dokumenti "Tabela 3" përmbledh një gamë të gjerë marrëveshjesh dhe projektesh të realizuara me institucione vendore dhe ndërkombëtare, ku secili fakultet i universitetit luan një rol të rëndësishëm. Bashkëpunimet janë realizuar me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim mësimdhënien si dhe kërkimin shkencor:

Bashkëpunime me institucione vendore - Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka nënshkruar një marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër për zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve që mbështesin ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Kjo përfshin organizimin e trajnimeve dhe përfshirjen e studentëve në projekte të drejtpërdrejta të restaurimit dhe konservimit. **Fakulteti i Drejtësisë** ka bashkëpunuar me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) për ofrimin e praktikave profesionale për studentët e programit të drejtësisë, duke krijuar lidhje të ngushta midis formimit teorik dhe praktikës në fushën juridike. **Fakulteti i Edukimit:** Në kuadër të marrëveshjes me Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) Lezhë, studentët e programit të Mësuesisë realizojnë praktikën profesionale në shkollat e rajonit. Kjo iniciativë është një komponent thelbësor për zhvillimin profesional të studentëve të Fakultetit të Edukimit.

Projekte infrastrukturore: Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka përfituar nga një investim i përbashkët me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) për modernizimin e ambienteve të fakultetit, duke përmirësuar infrastrukturën për mësimdhënie dhe kërkime shkencore.

Partneritete ndërkombëtare

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja: Bashkëpunimi me Universitetin e Salentos (Itali) ka sjellë krijimin e një programi të dyfishtë diplome në Trashëgimi Kulturore. Ky program u jep studentëve mundësinë të ndjekin studime të avancuara në një ambient ndërkombëtar, duke u pajisur me dy diploma të njohura ndërkombëtarisht. **Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës:** Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Universitetin Fulda (Gjermani) është përqendruar në shkëmbimin e njohurive shkencore dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka nënshkruar marrëveshje me English Language Teachers Association (ELTA) Albania për zhvillimin e seminareve dhe konferencave në dobi të mësuesve të gjuhës angleze, duke rritur standardet e formimit profesional në këtë fushë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Fakulteti i Drejtësisë: Marrëveshjet me universitete si Universiteti Ionian (Greqi), Universiteti Educons (Serbi) dhe Universiteti Haute-Alsace (Francë) janë përqendruar në shkëmbimin e përvojave akademike dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore ndërkombëtare. Këto bashkëpunime përfshijnë trajnime të stafit akademik, shkëmbime studentësh dhe organizimin e konferencave të përbashkëta shkencore.

- 1. Fakulteti i Shkencave të Edukimit:** Në bashkëpunim me Shoqatën Filipide (Itali), fakulteti ka zhvilluar projekte që adresojnë sfidat në sport dhe autizëm, duke përfshirë organizimin e aktiviteteve sportive për persona me aftësi të kufizuara.
- 2. Departamentet e Fakultetit të Ekonomisë,** kanë vendosur dhe mbajnë lidhje dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, me biznese dhe me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit..

Projekte specifike dhe rezultate konkrete

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Provinca Françeskane Shqiptare kanë organizuar dy konferenca kombëtare gjatë vitit akademik 2023-2024, duke krijuar një platformë për diskutim të thelluar mbi çështjet e trashëgimisë kulturore dhe sociale.
- Fakulteti i Edukimit ka përfituar nga marrëveshjet me Shkollën e Drejtorëve (IARD) për trajnimin e drejtorëve dhe nën-drejtorëve aktualë në fushën e lidërshiptit arsimor.
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), ka zhvilluar trajnime për përfshirjen e studentëve në procese kërkimore mbi analizat statistikore.

Përfitimet strategjike

Këto bashkëpunime kanë ndihmuar universitetin të forcojë kapacitetet e tij akademike dhe kërkimore, të zgjerojë mundësitë për studentët dhe stafin akademik dhe të rrisë ndikimin e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Rezultatet konkrete përfshijnë krijimin e programeve të reja akademike, ngritjen e laboratorëve kërkimorë dhe përfshirjen e studentëve në projekte me impakt të gjerë. Kjo qasje e integruar ndaj bashkëpunimit ndërinstitucional dëshmon angazhimin e Universitetit të Shkodrës për t'u shndërruar në një qendër ekselence në rajon dhe më gjerë, duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit.

Gjatë vitit akademik 2023 – 2024 Universiteti I Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka nënshkruar 21 marrëveshje me institucione shqiptare dhe 8 marrëveshje me universitete dhe shoqata të ndërkombëtare. Universiteti dhe institucionet bashkëpunuese zhvillojnë projekte të përbashkëta që përfshijnë ndërkombëtarizimin, shkëmbimet akademike, programet e studimit, trajnimet, kërkimin shkencor, dhe organizimin e aktiviteteve kulturore apo konferencave shkencore. Në mënyrë specifike, fushat përfshijnë trashëgiminë kulturore, statistikat, drejtësinë, arsimin, biodiversitetin dhe shëndetësinë.

1. Detyrat e palëve:

- Institucionet bashkëpunuese: Ofrimi i ekspertizës, mbështetja në organizimin e aktiviteteve dhe projekteve, sigurimi i praktikave profesionale dhe shkëmbimi i stafit akademik dhe studentëve.
- Universitetet: Implementimi i projekteve sipas fazave të përcaktuara, zhvillimi i kurrikulave dhe programeve të reja studimore, promovimi i trajnimeve dhe pjesëmarrja në aktivitete kërkimore e shkencore.

2. Produktet e bashkëpunimit:

- Krijimi i diplomave të dyfishta dhe modernizimi i kurrikulave.
- Hartimi i materialeve shkencore dhe promovuese.
- Organizimi i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ngritja e laboratorëve të rinj dhe sistemeve moderne për statistika dhe analiza shkencore.

Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin institucional (shtojca 1)

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAI ose mbi projektet ku merr pjesë si palë aktive, I cili përfshin

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka aplikuar dhe është përfshirë në disa projekte gjatë vitit akademik 2023-2024. Projektet e evidentuara përfshijnë qasje kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfaqësuar një përpjekje të qëndrueshme për përmbushjen e objektivave të strategjisë së zhvillimit për periudhën 2022-2026, veçanërisht për ndërkombëtarizimin, përfshirjen sociale dhe avancimin akademik. Aktualisht Universiteti I Shkodrës ka në zbatim 17 projekte, nga të cilat 10 janë projekte capacity building Erasmus, ndërsa 5 projekte të kërkimit shkencor janë të

financuara nga nga AKKSHI dhe Western Balkans Fund. Gjithashtu, në kuadrin e thirrjes READ, janë në zbatim 5 projekte të financuara nga AADF.

1. **Fakulteti i Shkencave të Edukimit**, anëtarët e tij janë të përfshirë në 4 projekte për rritje kapacitetesh, Erasmus, 1 UNDP, 1 nga Ambasada Amerikane.

Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale:

- Projekti "Forcimi i kapaciteteve të studentëve të shkencave sociale dhe profesionistëve të shërbimeve sociale": Ky projekt kombëtar, i zbatuar në partneritet me Universitetin e Tiranës dhe Universitetin "Aleksandër Xhuvani", financiar nga programi UNDP Albania, adreson fuqizimin e kapaciteteve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe ndihmën për grupet vulnerabël.
- Projekti Erasmus+ "E-Le.G.A.N.T.S": Ky projekt ndërkombëtar fokusohet në zhvillimin e aftësive për sipërmarrësit e rinj përmes trajtimeve gamifikues dhe digjitalizuar, duke i përshtatur studentët me sfidat moderne të tregut.

Departamenti i Mësuesisë:

- "CRED4TEACH": Ky projekt i bashkëfinancuar nga Erasmus+ synon krijimin e mikro-kredencialeve për zhvillimin profesional të mësuesve, duke ofruar një qasje të re ndaj trajnimit dhe zhvillimit të aftësive mësimore.
- "Media dhe Edukimi Mediatik për Mësuesit e Ardhshëm": Një projekt i zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias dhe i financuar nga Ambasada Amerikane, që përqendrohet në pajisjen e studentëve të mësuesisë me njohuri mbi median dhe informacionin.

2. **Fakulteti i Shkencave Shoqërore** 2 projekte financuar nga Western balkans Fund, 1 financiar nga RISI Albania, 1 financiar nga AKKSHI, 1 financiar nga Oxford Internet Institute

Projekte Kombëtare:

- "Kolë Thaçi – shtetari poet": Një monografi e realizuar me kontributin e Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Fakultetit të Drejtësisë, që promovon trashëgiminë kulturore dhe historike të Shqipërisë.
- "Shtypi në Shkodër deri në vitin 1920": Një projekt albanologjik i financuar nga AKKSHI, i cili synon digjitalizimin dhe ruajtjen e dokumenteve historike mbi shtypin në Shkodër.

Projekte Ndërkombëtare:

- "Media 2040: Empowering Youth Advocates for Press Freedom": Një projekt rajonal që përfshin bashkëpunimin me universitete në Kosovë, Bosnjë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut për rritjen e ndërgjegjësimit mbi lirinë e medias dhe rolin e të rinjve.

3. **Fakulteti i Drejtësisë**

- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "CONFLAË24": Një iniciativë që trajton përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së dhe përvojat krahasuese nga vende të tjera. Ky aktivitet forcon lidhjet akademike ndërkombëtare dhe kontribuon në debatet mbi reformën ligjore.
- Projekti për ndihmën juridike falas: Ky projekt ndihmon grupet vulnerabël në veri të Shqipërisë duke përfshirë studentët në ofrimin e ndihmës juridike dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre.

4. **Fakulteti i Shkencave Natyrore**– 3 projekte financuar nga AKKSHI, thirrja e infrastrukturës (PIKSH) dhe Universiteti I Shkodrës, 3 projekte Interreg, 2 nga Universiteti I Shkodrës, 1 projekt në kuadrin e READ dhe 1 Erasmus +. 11 projekte janë në zbatim, 2 projekte në proces vlerësimi. 1 projekt i përfunduar në Prill të 2024, 2 projekte (mos lëvrime fondesh) 1 projekt fitues (mungesë fondesh)

- Fakulteti është përfshirë në projekte ndërkombëtare për modernizimin e laboratorëve dhe përmirësimin e kurrikulave.
- Pjesëmarrja në projekte për energjitë e rinovueshme dhe biodiversitetin ka ndihmuar

në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e kapaciteteve kërkimore të stafit dhe studentëve.

5. **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**, 1 projekt financiar nga AUF dhe 1 nga Ambasada Amerikane Departamenti i Romanistikës:

- Programi Bachelor "Gjuhë të Huaja për fushën e Turizmit": Në partneritet me Universitetin Haute Alsace, ky projekt adreson nevojën për programe studimi që mbështesin zhvillimin e turizmit dhe punësimin në sektorin ekonomik të rajonit.

Departamenti i Gjuhës Angleze:

- Projekti "Communicative and Brain-Based Learning through Literature": Një nismë për përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës angleze përmes qasjeve inovative, duke përfshirë mësimdhënie të përbashkët dhe zhvillimin e kurrikulës për master profesional.

6. **Fakulteti Ekonomik** 2 projekte në kuadrin e programeve Erasmus, 3 projekte financuar nga AADF, WBF dhe 1 financiar nga Oxford Internet Institute. Aplikuar edhe në thirrjet e AKKSHI-t dhe të tjera Erasmus, por shpallur jo fitues.

Projekte Ndërkombëtare:

- SMART (Sustainable Smart Solutions): Ky projekt zhvillon qendrat inovative në Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur sipërmarrjen dhe zgjidhjet e qëndrueshme.
- Projekti "Open Eastern Balkan Collaboratory on Online Platform Eörk": Përqendrohet në zhvillimin e një platforme pune përmes kërkimeve mbi ekonominë digjitale dhe sfidat e saj në rajon.

Projekte Kombëtare:

- "Shkodra dhe Veriu i Shqipërisë: Inovacion në Ekoturizëm": Një nismë që lidh turizmin dhe inovacionin për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të rajonit.

Projektet e kërkimit shkencor të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" janë në përputhje të plotë me objektivat e strategjisë së zhvillimit. Ato mbështesin:

- Ndërkombëtarizimin: Përmes partneriteteve të gjera me universitete evropiane dhe rajonale.
- Zhvillimin e qëndrueshëm: Përmes projekteve që integrojnë kërkimin shkencor me nevojat e komunitetit dhe tregut të punës.
- Avancimin akademik dhe kërkimor: Përmes modernizimit të infrastrukturës dhe përfshirjes së stafit e studentëve në projekte ndërdisiplinore.

Këto nisma jo vetëm që forcojnë kapacitetet e universitetit, por edhe e pozicionojnë atë si një institucion lider në zhvillimin rajonal dhe kombëtar.

Tabela nr. 4: Mbi projektet e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim

Tabela 4.2 Mbi aktivitetin shkencor të stafit akademik të USH

ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka përfshirë kërkimin shkencor si një element të pandashëm të misionit të tij akademik. Kërkimi shkencor është ndërthurur me mësimdhënien në fakultetet e universitetit, duke përmirësuar cilësinë e arsimit dhe duke nxitur përfshirjen e studentëve në aktivitete akademike dhe praktike. Kërkimi shkencor ndihmon në përditësimin e programeve të studimit dhe në përmirësimin e kurrikulave, duke e bërë mësimdhënien më të lidhur me nevojat bashkëkohore të tregut të punës dhe zhvillimet globale. Fakultetet dhe departamentet kanë organizuar një sërë aktivitete, duke përfshirë konferenca studentore, ekspozita, leksione të hapura dhe projekte kërkimore, që kanë pasuruar eksperiencën mësimore të studentëve dhe kanë ndihmuar në zhvillimin profesional të tyre.

Fakulteti i Drejtësisë

Fakulteti i Drejtësisë ka luajtur një rol kyç në kombinimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien, duke organizuar leksione të hapura dhe forume diskutimi. Aktivitetet përfshijnë:

- **Tryezë diskutimi mbi llogaridhënien qeveritare**, organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Eëstminster, ku u trajtua rëndësia e parandalimit të korrupsionit në proceset legislative.
- **Forumi i integritetit dhe luftës kundër korrupsionit**, me pjesëmarrjen e Kreut të SPAK-ut, Altin Dumani.
- **Promovimi i librit "Ora e Kosovës"**, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Shoqërore.

Këto aktivitete kanë ndihmuar studentët dhe pedagogët të ndërlidhin teorinë me praktikën, duke kontribuar në përgatitjen e një brezi të ri profesionistësh të angazhuar për demokratizimin dhe sundimin e ligjit.

Fakulteti Ekonomik

Në këtë fakultet, kërkimi shkencor është përdorur për të forcuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës në ekonomi dhe turizëm. Disa prej aktiviteteve kryesore janë:

- **Workshop mbi turizmin e qëndrueshëm**: Në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe studentët e doktoraturës, janë trajtuar temat e zhvillimit të turizmit gjithëvjetor dhe atraktivitetit të rajonit të veriut.
- **Prezantimi i planeve kërkimore nga studentët e doktoraturës në ekonomi dhe turizëm**: Një aktivitet i cili ndihmoi studentët të strukturojnë dhe të prezantojnë punimet e tyre kërkimore.
- **Forumi i Turizmit Ndërkombëtar**: Në kuadër të lëndës "Marketing Turistik Ndërkombëtar", studentët dhe pedagogët kanë punuar së bashku për të identifikuar zgjidhje inovative për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Këto aktivitete kanë forcuar kapacitetet kërkimore dhe mësimore të fakultetit, duke përfshirë studentët në problematika praktike dhe duke përmirësuar kurrikulat për t'iu përshtatur zhvillimeve bashkëkohore.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Departamenti i Gjuhës Angleze ka zhvilluar projekte kërkimore që përfshijnë studentët, si:

- **"Eksplorim gjuhësor në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore"**: Studentët e vitit të tretë Bachelor analizuan përdorimin e gjuhës angleze në sektorin e turizmit dhe kulturës, duke ndërthurur kërkimin në terren me mësimdhënien.
- **Projekti "English History in Posters"**: Një aktivitet kreativ ku studentët analizuan dhe prezantuan momente kyçe të historisë dhe kulturës angleze.

Këto iniciativa jo vetëm që thelluan njohuritë e studentëve, por gjithashtu kontribuan në përmirësimin e aftësive analitike dhe komunikative të tyre.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, aktivitetet kërkimore janë kombinuar me mësimdhënien për të nxitur zhvillimin e aftësive praktike dhe artistike. Disa shembuj përfshijnë:

- **Ekspozita mbi edukimin mediatic**, ku studentët prezantuan punimet e tyre mbi ndikimin e rrjeteve sociale në jetën shoqërore.
- **Ekspozita artistike dhe punime kreative** në Galerinë e Arteve Shkodër, të kuruara nga pedagogë dhe studentë, duke krijuar lidhje mes teorisë dhe praktikës artistike.

Fakulteti i Shkencave Natyrore

Studentët e programeve Bachelor dhe Master janë përfshirë në kërkime që trajtojnë çështje mjedisore dhe biologjike. Konferencat studentore, si ajo e organizuar për Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, kanë ndihmuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore.

iii) Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrje në veprimtari Brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka pasur një vit të suksesshëm në fushën e kërkimit shkencor, me angazhime të thelluara në fusha të ndryshme akademike dhe kërkimore. Aktivitetet shkencore të universitetit janë shtrirë në një gamë të gjerë tematikash, duke përfshirë botime shkencore, konferenca, dhe projekte kërkimore të rëndësishme.

Çdo fakultet ka luajtur një rol të rëndësishëm në pasurimin e literaturës shkencore dhe përfundimin e lidhjes mes kërkimit dhe mësimdhënies, duke sjellë rezultate konkrete dhe ndikime pozitive në fusha të ndryshme akademike dhe praktike.

Fakulteti i Drejtësisë me pjesëmarrje në 21 konferenca shkencore (kombëtare e ndërkombëtare) ku shumica e prezantimeve janë shoqëruar me publikimin e artikujve përkatës. Stafit akademik ka realizuar 17 prezantime në konferenca shkencore ndërkombëtare prej të cilave: 5 në konferenca jashtë vendit (vende të OECD+BE); 6 në konferenca jashtë vendit; 6 në konferenca ndërkombëtare brenda vendit dhe 4 ëorkshope. Gjatë vitit 2023-2024, janë publikuar 5 artikuj shkencorë (prej të cilëve 4 në revista jashtë vendit/ vende të OECD+BE; 1 botim brenda vendit. Në Fakultetin e Drejtësisë, kërkimi shkencor është përqendruar në të Drejtën Ndërkombëtare dhe Europiane, duke trajtuar tema që lidhen me ndikimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Europian. Artikujt dhe studimet janë përqendruar gjithashtu në aspekte praktike si kontratat tregtare dhe arbitrazhi, duke kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar. Për më tepër, një fokus i veçantë i hulumtimeve ka qenë migracioni dhe politikat sociale, duke analizuar rolin e bashkimit familjar dhe sfidat e migracionit në kontekstin rajonal dhe ndërkombëtar.

Fakulteti Ekonomik – 94 pjesëmarrje në konferenca, në të cilat 82 ndërkombëtare dhe 8 kombëtare. 29 botime në revista ndërkombëtare të indeksuara. Fakulteti Ekonomik ka pasuruar debatet shkencore me hulumtime që eksplorojnë ndikimin e ekonomisë qarkulluese dhe zhvillimit të qëndrueshëm në sektorë të rëndësishëm si turizmi dhe bujqësia. Botimet shkencore kanë trajtuar tema si marketingu digjital dhe ndikimi i tij në industrinë e hotelerisë, si dhe përshtatjet strategjike të ndërmarrjeve për të përballuar transformimin teknologjik. Ndërkohë, analiza mbi politikat fiskale dhe ekonominë rajonale ka kontribuar në kuptimin e sfidave dhe mundësive që ofron rajoni i Ballkanit Perëndimor, duke adresuar ndikimin e të ardhurave nga taksat dhe mbështetjen qeveritare për bizneset e vogla dhe të mesme.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja 14 konferenca, në të cilat 12 ndërkombëtare dhe 2 kombëtare. Në 9 botime në revista shkencore, 1 është në buletinin e universitetit, 8 të tjera në revista të indeksuara. Kërkimi ka pasuruar si fushën e gjuhëve të huaja, anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, ashtu edhe atë të kulturës. Studimet mbi ndikimin e gjuhëve të huaja në turizëm dhe kulturë kanë hapur rrugë të reja për përdorimin e gjuhës si një mjet zhvillimi ekonomik. Po ashtu, projekte si “English History in Posters” kanë integruar histori dhe letërsi, duke angazhuar studentët në analiza kritike dhe kreative. Për më tepër, ndërthurja e kulturës dhe gjuhës ka qenë një temë kyçe, duke promovuar ndërveprimin ndërkulturor dhe turizmin kulturor si mjete për zhvillim rajonal.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore – 122 konferenca, në të cilat 46 ndërkombëtare dhe 46 kombëtare. Anëtarët e këtij fakulteti kanë kontribuar ndjeshëm në studime që lidhen me gjuhësinë, letërsinë, trashëgiminë kulturore dhe historinë e rajonit. 56 artikuj të botuar në revista shkencore, 23 botime brenda vendit dhe 33 jashtë vendi, 1 monografi, 2 tekste universitare, 12 përkthime. Projekti “Kolë Thaçi – shtetari poet” ka qenë një nismë e rëndësishme për dokumentimin e historisë dhe

kulturës shqiptare, ndërsa studimet mbi shtypin e hershëm në Shkodër kanë ndihmuar në ruajtjen dhe promovimin e burimeve të rëndësishme kulturore dhe historike. Gjithashtu, hulumtimet mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në turizëm kanë sjellë propozime konkrete për zhvillimin e qëndrueshëm turistik, duke lidhur kërkimin me problematika praktike dhe aktuale.

Fakulteti i Shkencave Natyrore – 62 konferenca, në të cilat 3 kombëtare dhe 59 ndërkombëtare. 23 botime në revista shkencore jashtë vendit, 19 botime në revista shkencore brenda vendit, 8 pedagogë të FSHN janë në proces për të marrë gradën Doktor i Shkencave, Pjesëmarrje në 12 borde shkencore, 1 monografi, 3 tekste universitare, 1 liber (në botim), Udhëheqja shkencore dhe 1 dizertacioni, Pjesëmarrje në 32 trajnime workshope dhe certifikime, nga 13 pedagogë të FSHN-së, 4 pjesëmarrje në mësimdhënie në Universitetet e huaja (leksione të hapura). Anëtarët e këtij fakulteti kanë treguar një fokus të veçantë në çështjet e biodiversitetit dhe energjive të rinovueshme, duke kontribuar në ruajtjen e burimeve natyrore dhe në promovimin e praktikave mjedisore të qëndrueshme. Hulumtimet mbi përdorimin e provave elektronike në proceset penale dhe ndikimi i teknologjive të reja në shkencat natyrore kanë qenë një kontribut i rëndësishëm në ndërthurjen e kërkimit shkencor me zhvillimet bashkëkohore teknologjike.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit – 27 konferenca kombëtare dhe 20 ndërkombëtare. 18 botime në revista shkencore, 7 brenda vendit dhe 11 të tjera të indeksuara.

Në Fakultetin e Edukimit, aktivitetet kërkimore kanë qenë të orientuara drejt zhvillimit të aftësive praktike dhe krijimtarisë. Edukimi mediatik ka qenë një temë kryesore, ku studentët dhe pedagogët kanë eksploruar ndikimin e rrjeteve sociale në edukimin dhe mirëqenien sociale. Po ashtu, ekspozitat artistike dhe projektet kreative kanë përfshirë studentët në aktivitete që lidhin teorinë me praktikën, duke promovuar aftësitë krijuese dhe ndërdisiplinore.

Stafi akademik është gjithashtu i përfshirë në borde editorial dhe në projekte, përkatësisht:

Fakulteti I Shkencave Shoqërore – 26 anëtarë

Fakulteti I Shkencave Natyrore – 34 anëtarë

Fakulteti I Shkencave të Edukimit – 27 konferenca kombëtare dhe 20 ndërkombëtare.

Fakulteti Ekonomik – 7 anëtarë të revistave dhe bordeve të ndryshme,

Fakulteti I Drejtësisë angazhuar në bordet shkencore të konferencave të realizuara nga vetë fakulteti.

Fakulteti I Gjuhëve të Huaja - 2 udhëheqje doktorature, një nga të cilat në Universitetin Haute Alsace në Francë, 3 borde editoriale, 3 vlerësime projektesh, 6 vlerësime artikujsh shkencorë në revista të indeksuara, 3 anëtarësime në komisione shkencore vlerësimesh, 1 antërasim në bord editorial në revistë shqiptare.

Tabela nr. 5: Mbi aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara (Stojca 1)

iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka ndërtuar dhe zhvilluar një infrastrukturë të dedikuar për mbështetjen dhe realizimin e kërkimit shkencor, duke përfshirë pajisjen e sallave, laboratorëve dhe bibliotekave me mjete teknike të nevojshme. Përveç kësaj, universiteti ka ngritur sisteme menaxhimi për mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit, duke garantuar një mjedis kërkimor bashkëkohor dhe të sigurt. Universiteti disponon salla të mëdha leksionesh, si dhe salla seminari që përdoren për mësimdhënie dhe trajnime. Laboratorët: Fakulteti i Shkencave Shoqërore përfshin Laboratori Hartografi dhe Gjeologji, Laboratori I trashëgimisë kulturore të pajisur me teknologji të specializuar për analizë dhe vizualizim të të dhënave. Fakulteti i Shkencave Natyrore operon Qendrën e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolfdieter Sixl”, e cila kryen analiza mikrobiologjike për baktere, kërpudha, parazitë dhe cilësinë e ujërave. Klinika e Ligjit brenda Fakultetit të Drejtësisë ofron mundësi për praktikë juridike dhe shërbime për komunitetin. Bibliotekat: Universiteti disponon biblioteka që mbështesin kërkimin dhe mësimdhënien, duke ofruar qasje në materiale të ndryshme shkencore. Infrastruktura Digjitale: Universiteti është i pajisur me një sistem shërbimi të internetit për të mbështetur kërkimin shkencor dhe aktivitetet didaktike.

d-Të dhëna mbi programet e studimit

i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.

ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.

Gjatë vitit akademik 2023-2024 USH ka ofruar programe studimi të të tre cikleve të cilët në total janë 68 programe studimi aktive si më poshtë:

Cikli i tretë i studimeve 2 programe

- "Doktoratë" në "Gjuhë Shqipe"
- "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"

Cikli i dytë i studimeve 37 programe nga të cilët 3 janë pasivë nga ku:

- Master Shkencor 12 programe
- Master profesional 22 programe

Cikli parë i studimeve bachelor

- 30 programe studimi (2 janë pasivë)
- Programe formimi profesional 3 programe
- Program i formimit të vazhduar 1 program

Në figurën 1 paraqiten programet e studimit që ofron USH në përqindje sipas cikleve




Figura 1. Përqindja e programeve të studimit sipas cikleve

Nga figura 1 vërehet se 50% e programeve të ofruara nga USH janë programe master. Numri më i lartë i programeve të ciklit II i jep më shumë mundësi zgjedhjeje studentëve për specializimin e tyre pas përfundimit të studimeve në sistemin Bachelor.

Nga të gjithë programet e studimit që ofron USH, aktualisht në proces akreditimi janë 10 programe studimi të ciklit të parë. Ndërsa studimi i tregut është bërë për pesë programe studimi që ofron USH.

Në figurën 2 paraqitet numri i programeve të aktivizuara sipas cikleve të studimit në tre vitet e

fundit në USH (nga viti akademik 2021-2022 në vitin akademik 2023-2024). Vërehet se në vitin 2022 janë aktivizuar për herë të parë 9 programe studimi (3 bachelor, 4 master 1 doktoraturë dhe 1 profesional) në vitin 2023 ,3 programe (1 bachelor 1 master dhe 1 program formimi vazhduar) të cilët janë:

- Program studimi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko - Pedagogjike
- Master Profesional në "Pedagogji Speciale"
- Bachelor në "Shkencat e Ushqimit"




Figura 2. Programet e studimit të aktivizuara në tre vitet e fundit në USH sipas Cikleve të studimit

Pasqyra e plotë e programeve të studimit që ofron USH paraqitet në tabelën 7 "Mbi programet e studimit" në shtojcën 1.

iii. IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

Programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Shkodrës janë në të njëjtën linjë me misionin dhe objektivat strategjike të tij në fushën e mësimdhënies

Ofrimi i Arsimit të Lartë Cilësor dhe Gjithpërfshirës:

- Sigurimi i një procesi mësimor që respekton standardet kombëtare të cilësisë.
- Krijimi i mundësive për të gjithë studentët në një mjedis transparent dhe me integritet akademik.
- Mbështetja në standardet ndërkombëtare për të garantuar një nivel të lartë akademik.
- Promovimi i kërkimit shkencor si një shtyllë kryesore e zhvillimit dhe mbështetjes së mësimdhënies.

Programet e studimit të ofruara nga USH vlerësohen si programe ku harmonizohen përgatitja teorike e studentëve me atë praktike, duke synuar rritjen e përgatitjes së studentëve për tregun global të punës.

Hartimi i programeve të studimit bazohet në standardet shtetërore të cilësisë, Në VKM Nr. 824 datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të cilësisë së arsimit të lartë", VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar, në udhëzimin në 29 datë 10.09.2018 i MAS "për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar dhe në Vendimin e Senatit

Akademik (SA) të USH nr. 182, datë 28/05/2018 " Për miratimin e Rregullores së studimeve në USH", ndryshuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 218/1, dt.22/01/2020; Nr. 145/2022 dhe Nr. 130/2023.

Nga analizat e bëra në fakultete rezultojnë problematikat e mëposhtmenë lidhje me përshtatshmërinë e programeve me misionin e Institucionit.

Programet e studimit të ofruara nga *Fakulteti Ekonomik* janë projektuar dhe përditësohen periodikisht për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Synimi kryesor është përgatitja e studentëve për të qenë konkurrues dhe të aftë për t'u integruar me sukses në tregun e punës. Për këtë qëllim, studentët plotësojnë formimin e tyre akademik praktikë profesionale, të cilat ndihmojnë në aplikimin praktik të njohurive të fituara dhe lehtësojnë procesin e integritimit në karrierën profesionale.

Të tre departamentet vijojnë të punojnë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve studimore, duke i përshtatur ato me trendet e reja dhe kërkesat e sektorit ekonomik. Kjo qasje garanton që studentët të pajisen me njohuri dhe aftësi bashkëkohore, duke i bërë ata të gatshëm për sfidat e së ardhmes.

Synimi *Fakultetit të Shkencave të Natyrës* është sigurimi i një mësimdhënieje cilësore dhe një përfshirje më të madhe në drejtim të kërkimit shkencor nga ana e pedagogëve dhe studentëve si dhe rritje të konkurrencës së diplomave. FSHN luan një rol shumë të rëndësishëm në orientimin dhe nxitjen e studentëve drejt tregut të punës dhe përshtatjen e kapaciteteve dhe aftësive të studentëve me nevojat dhe kërkesat gjithnjë në rritje dhe ndryshim të tregut të punës.

Strategjia e Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin e Shkodrës fokusohet në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ndërkombëtarizimin. Këto synime do realizohen përmes:

Përmirësimi të programeve akademike: Fakulteti synon përshtatjen e kurrikulave me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut të punës.

Zhvillimit të projekteve kërkimore: Përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare është një prioritet për të avancuar shkencërisht dhe për të promovuar inovacionin.

Bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare: Fakulteti ka marrëveshje për shkëmbimin e studentëve dhe stafit, organizimin e aktiviteteve shkencore, dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Mbështetjen e zhvillimit të stafit akademik: Inkurajimi i vazhdueshëm për kualifikime të larta si doktoratat dhe përmirësimin e kompetencave pedagogjike

Programet e studimit pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. Objektivat e programeve, gjithashtu, janë në harmoni me Strategjinë e USH-së si dhe janë në funksion të realizimit të objektivave të saj. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e studimeve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Procesi i mësimdhënies në FSHE i orientuar me misionin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". P

Për realizimin e synimeve të mësimdhënies FSHE ofron:

- Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të MASR, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.
- Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim të tij.
- Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.
- Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.
- Numër të lartë aktiviteteve të realizuara nga pedagogët me student.
- Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.

- Bashkëpunim të vazhdueshëm të FSHE me komunitetin akademik, e më gjerë.

Programet e studimit që mbulojnë njësitë bazë të *Fakultetit të Shkencave Shoqërore* janë të konsoliduara prej vitesh dhe realizojnë me cilësi të gjitha objektivat e përcaktuara. Për sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve, planeve mësimore, programeve të lëndëve, infrastrukturës etj., departamentet e FSHSH në përgjithësi i përmbushin të gjitha standardet akademike të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Studentët tanë marrin formimin e duhur dhe të pritshëm në fushën e tyre profesionale dhe janë konkurrenca me të diplomuarit në programe të ngjashme studimi në universitetet e tjera të vendit.

Programet e studimeve që mbulojnë departamentet e FSHSH-së synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit ekonomik, kombëtar e rajonal, ku përparësi kanë degët që zhvillojnë aftësi të aplikueshme në tregun e punës.

Programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Drejtësisë janë në të njëjtën linjë me misionin dhe objektivat strategjike të USH-së, konkretisht atë të mësimdhënies, e cila synon në: arritjen e standarteve të larta në mësimdhënie, si dhe aplikimin e standarteve të larta në vlerësimin institucional dhe programeve të studimit.

Fakulteti i Drejtësisë synon ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike, shkencore dhe profesionale në fushën e së drejtës, duke përgatitur për ndjekjen e Shkollës së Magjistraturës dhe shkollimit në profesionet e lira, por edhe në ushtrimin e profesionit si punonjës të administratës publike dhe asaj gjyqësore, nëpunës gjyqësorë civilë. Duke ofruar një kurrikulum të larmishëm, programet e studimit ofrojnë mundësinë studentëve për të marrë njohuritë bashkëkohore dhe zhvilluar aftësimin praktik në fushën e së drejtës, gjë që mundëson edhe lëvizjen e tyre për studime jashtë vendit dhe ekuivalentimin e diplomave të tyre.

Programet e studimit që ofrohen nga *Fakulteti i Gjuhëve të Huaja* janë në përputhje me strategjinë e USH për mësimdhënies dhe fokusohen në objektivat e mëposhtme:

-përmirësimin dhe perfeksionimin e njohurive gjuhësore, ku nëpërmjet lëndëve me karakter gjuhësor studentët duhet të aftësohen që të shprehin dhe interpretojnë në gjuhë të huaj, si me gojë ashtu edhe me shkrim, koncepte, ide, ndjenja, fakte dhe mendime (në anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht);

- formimin e studentëve me njohuritë bazë shkencore të fushës së gjuhësisë, të letërsisë e kulturës së vendeve anglofone, të vendeve frankofone, të gjuhës, të letërsisë e kulturës italiane si dhe të gjuhës, letërsisë e kulturës së vendeve gjermanishtfolëse;
- aftësimin e studentëve në fushën e translacionit dhe fushën e komunikimit ndërkulturor
- objektivat formuese për përgatitjen e studentëve me shprehje shumë të mira si mësues të gjuhës angleze, italiane, frënge e gjermane;
- metodotat e mësimdhënies së gjuhës së huaj nëpërmjet platformave dixhitale, psh nëpërmjet përdorimit të learning apps etj.;
- orët reale të praktikave mësimore si një domosdoshmëri, ku njohuritë teorike duhet të gjejnë zbatim në praktikë dhe kjo përball studentët me realitetin e punës së mësuesit.
- Programet lëndore janë hartuar në përputhje të plotë me objektivat e planit mësimor për secilin program studimi Bachelor dhe Master.

Ndër objektivat strategjike të USH për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përshtatshmërinë e programeve të studimit me tregun e punës mund të veçohen:

Përditësimi i programeve të studimit

Nga analiza e punës mësimore dhe shkencore në departamente vërehet angazhimi i stafit akademik për përditësimin e programeve të studimit që ofron USH me kërkesat që ka tregu i punës. Puna në këtë drejtim është fokusuar në futjen e lëndëve të reja me synim përgatitjen e studentëve për tregun global të punës dhe shtimin e disiplinave ndërlëndore në programet e studimit që çdo departament ofron. Në programet e studimit është rritur numri i moduleve

ndërlëndore me zgjedhje për studentët.

Përditësimi i sylabuseve

Puna për ofrimin e sylabuseve sa më bashkëkohore dhe që ti shërbejnë studentëve në tregun e punës është analizuar në çdo departament të USH. Është rritur kërkesa për literaturë bashkëkohore nga anëtarët e stafit akademik që sylabuset të bazohen në literaturën më të re bashkëkohore dhe të përafrohen me universitetet e huaja që veprojnë në fusha të njëjta ose të përafërta.

Ngritja e laboratorëve të rinj dhe pasurimi i atyre ekzistues

Në departamentet që ofrojnë praktika laboratorike është diskutuar shtimi i orëve të praktikave dhe fuqizimi i bazës laboratorike për studentët. Një moment i rëndësishëm i punës së departamenteve është dhe rritja e nukrit të laboratorëve shkencorë që janë në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.

Fuqizimi i praktikave profesionale

Zhvillimi i praktikave profesionale të studentëve, veçanërisht të studentëve në master është vlerësuar si një component shumë i rëndësishëm i procesit mësimor, i njohjes së studentëve me kërkesat e tregut të punës dhe njëkohësisht i njohjes së drejtimeve kryesore të biznesit në qytetin e Shkodrës dhe në rajon. Studentët e masterave profesionalë dhe shkencorë janë shprehur se praktika që kanë zhvilluar në institucionet e qytetit dhe në biznese ka ndikuar në njohjen e problematikave dhe në sugjerimet që ato japin për përmirësimin e programeve të studimit dhe të sylabuseve të lëndëve të veçanta.

e) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

a. Të dhëna në lidhje me ndryshimet në aktet e brëndshme të IAL-së, si rregulloret, kodet e etikës, statutet e IAL-së ose të Fakulteteve, duke parashtruar ndryshimet e bëra .

Referuar akteve të publikuara në faqen zyrtare të USH-së, gjatë vitit 2023-2024, rezultojnë të jenë kryer ndryshime/miratime të këtyre akteve:

Vendimi Nr. 218 datw 29.09.2023 i Senatit Akademik "Për miratimin e strategjisë së barazisë gjinore në USH".

Vendimi Nr. 21 datw 23.01.2024 i Senatit Akademik "Për miratimin e ndryshimit në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës" Linku web https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/vendim_nr.21_dt.23.01.2024.pdf

Vendimi nr. 23 datw 23.01.2024 i Senatit Akademik "Për miratimin e organogramës së USH-së". https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/vendim_nr.23_dt-23.01.2024.pdf

Vendim nr. 54 datw 28.02.2024 i Senatit Akademik "Për miratimin e strukturës së përgjithshme në USH" https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/776_senat_24_3.pdf

b. Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Gjatë periudhës 2023-2024, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSC) e Universitetit "Luigj Gurakuqi" ka zbatuar aktivitete për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe administrative. Fokuset kryesore përfshijnë:

- Riakreditimi institucional dhe akreditimi për 10 programe ekzistuese dhe 13 programe studimi të reja .

- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm për të ruajtur dhe zhvilluar cilësinë në nivel institucional dhe programor.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave të bazuara në praktikën më të mirë ndërkombëtare.

ZSC ka bashkëpunuar me ASCAL dhe njësitë bazë për zbatimin e rekomandimeve dhe përmbushjen e standardeve kombëtare. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Monitorim i cilësisë përmes RVB-ve, pyetësorëve dhe fokus-grupeve.
- Zhvillimi i strategjive për përmirësimin e proceseve universitare.
- Konsultime me grupet e interesit dhe trajnime për stafin akademik, administrativ dhe studentët.
- Rezultatet kanë përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe kanë forcuar komunikimin për një kulturë të qëndrueshme cilësie.

Aktivitetet e zhvilluara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë për vitin akademik 2023-2024 paraqitet në mënyrë të përmbledhur në

tabelën Nr 8 Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë

f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.

Angazhimi i personelit akademik gjatë vitit akademik 2023-2024 paraqitet në formë tabelare për çdo fakultet

Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik Fakulteti i Drejtësisë

Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik Fakulteti i Edukimit

Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar

i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatitin për një karrierë apo profesion të caktuar

ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

Universiteti i Shkodrës përgatit studentë të profesioneve të ndryshme, dhe bazuar në objektivat strategjike të USH përgatitja e specialistëve të aftë për tregun e punës është një nga kërkesat kryesore të të gjithë programeve të studimit. Të dhënat për gjurmimin e studentëve paraqiten në Tabelën 10.

Tabela 10 Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet

h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

a. Të dhëna mbi përbërjen e Këshillit Studentor, përgjatë vitit akademik që raportohet, dhe aktivitetet e realizuara nga ana e tyre

Tabela nr. 11: Mbi përbërjen e Këshillave Studentorë

b. Të dhëna mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet drejtuese të IAL-së dhe roli i tyre në këto organe vendimarrëse

Tabela nr. 12: Mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet e IAL-së



j) Të dhëna mbi studentët

i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.

iii) numrin e studentëve të shkëlqyer;

Tabela nr. 13: Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve

Në vitin akademik 2023-2024 numri i përgjithshëm i studentëve që studionin në USH Ciklin e parë të studimeve ishte 2335 studentë nga të cilët u regjistruan në vitin e parë 858 studentë

Në vitin Akademik 2023-2024 numri i përgjithshëm i studentëve që studionin në USH në Ciklin e dytë të studimeve (Master Shkencor, Master Profesional dhe program i integruar i nivelit të dytë) ishte 975 studentë ndërsa numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë të ciklit të dytë ishte 614 studentë.

Në vitin akademik 2023-2024 numri i përgjithshëm i studentëve që studionin në USH në programet e formimit profesional ishte 181 studentë.

iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar, të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;

Tabela nr. 14: Mbi numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar

vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;

Tabela nr. 19: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre

e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara nëkuadër të projekteve ndërkombëtare

Tabela nr. 29: Mbi mobilitetin e personelit akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS “Luigj Gurakuqi”

Tabela Nr. 1. Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Fakulteti Shkencave te Natyres						
1	Hapja e programit bachelor ne Shkencat e Ushqimit	Diskutimi ne departament dhe aplikimi	Departamenti Biologji-Kimi	U realizua hapja e programit	2023	
2	Hapja e programit profesional 2 vjecar “Specialist i larte elektrik”	Aplikimi	Departamenti i Fizikës	U realizua hapja e programit	2022	
3	Përmirësimi i infrastrukturës	Krijim dhe përmirësim i laboratoreve	Departamenti i Lëndëve Paraklinike	U realizua hapja e klinikes së Fizioterapisë	2023	Proçes hapjeje 3 laboratore
4	Zbatim i metodave bashkëkohore të mësimdhënies	Aplikimi në projektet e mësimdhënies	FSHN/Departamenti Biologji-Kimi FSHN/Departamenti Lëndëve Klinike	Pjesëmarrja në projektin Valex ,Teaching exchange eithin the frameöork of the Erasmus+	2020-2023	
5	Përditësimi i syllabuseve të lëndëve	Rishikimi i literaturës	Departamentet e FSHN	U realizua pjeserisht	2023	
6	Shtimi i stafit akademik me kohë të plotë	Kontrolli i rekrutimit të stafit	FSHN/Departamenti Lëndëve Paraklinike dhe Departamenti	U realizua shtimi i stafit me pedagogë të brendshëm	2024	
7	Akreditimi i programeve bachelor në Biologji-Kimi, Matematikë dhe Informatikë	Mbikëqyrja e përgatitjeve të dosjeve të aplikimit	Matematike https://asca.al/sq/informacione/lajme/lista-e-plote-e-programeve-te-studimit-te-cilat-jane-ne-proces-akreditimi	Në proçes që nga viti 2023	2023	
8	Sigurimi i mjediseve të përshatshme pune dhe kushteve optimale për stafin akademik	Ndërhyrjet në ambientet në nevojë	FSHN	Riparime të godinës së FSHN	2023-2024	
9	Rritja e bashkepunimit pedagog-student përmes përfshirjes së tyre në aktivitete shkencore	Konferenca studentore	FSHN/Departamenti Biologji-Kimi	U realizua konferenca në ditën botërore të mjedisit	2023	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"

10	Përmirësimi i infrastrukturës së ambjenteve të Departamentit Infiermieri në shërbim të procesit mësimor	FSHN/Dept i Lëndëve Paraklinike dhe Klinike	Përmirësimi i infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor nuk është realizuar nga strukturat përkatëse të Universitetit	2024
11	Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i mësimdhënies	Anketimi i studentëve	Studentët theksojnë si pika që kanë nevojë të rishikohen janë: aspektet teorike të seminareve në lëndë të ndryshme, ndarjen e pikëve të vlerësimit të vazhduar, realizimi i praktikave profesionale	2024
12	Përfshirja e studentëve në vlerësimin e punës së pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm	Feedback i pasqyruar në raportet e Vlerësimit të brendshëm	Përfshirja e studentëve ka qënë një hap pozitiv në këtë proces	2024

Fakulteti Ekonomik

Niveli Bachelor	Puna është përqendruar në ofrimin e mësimdhënies cilësore që përputhet me kërkesat e tregut dhe zhvillimet e fundit ekonomike.	Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, I Administrim biznesit dhe turizmit	Plotësisht 100%	Tetor 2023 - Shtator 2024
13	Përditësimi i leksioneve dhe përdorimit të literaturës bashkëkohore. Shtjellimi i materialeve teorike, realizimi i projekteve brenda lëndëve dhe në terren, si dhe trajtimin shkencor të përmbajtjeve	Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, I Administrim biznesit dhe turizmit	Realizuar plotësisht	Tetor 2023 - Shtator 2025
14	Arritje e rëndësishme ka qënë përfundimi me sukses i procesit të akreditimit për programet Bachelor në Administrim-Biznes, Financë-Kontabilitet dhe Turizëm.	Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, I Administrim biznesit dhe turizmit		
Niveli Master				





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS “Luigj Gurakuqi”



Tabela 4.2 Mbi aktivitetin shkencor të stafit akademik të USH

Nr	Emri i pedagogut	Njësia Kryesore	Njësia Bazë	Titulli i punimit/prezantimit	Vendi ku u mbajt	Titulli i konferencës	Vendi ku botohet	Titulli i Revistës
1	Eugena Bari	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	'Annulment and revocation of intercountry adoption. An overview of Albanian legislation'	Vjenë, Austri	International academic conference on business, education, humanities, and social sciences (Wei-vienna 2024),		
2	Adrian Leka	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	'In depth analysis of the legal framework for tourism-related land usage in Albania'	Shkoder, Shqiperi	"Reshaping Eco-Social Paradigm Toward Innovation and Sustainability"		
3	Adrian Leka (autor i dyte)	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	Behind the Numbers: Decoding the Victimization Rate in Albania and Advocating for a Data Revolution		Proceedings of the 15th International Multi-Conference on Complexity, Informatics and Cybernetics: IMCIC 2024, pp. 267-272 (2024); https://doi.org/10.54808/IMCIC2024.01.267		
4	Adrian Leka	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	An In-Depth Critique of Albania's Sex Offender Registry				
5	Idlir Duhanxhi	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	'Provat elektronike ne procesin penal, çmuarja e tyre dhe vlera provuese'	Tirane, Shqiperi	Konferencë e 9-të Shkencore "Krimi dhe Siguria Kibernetike" organizuar nga Akademia e Sigurisë - Qendra e Kërkrimeve Shkencore dhe Projekteve		
6	Florida Arrinaj	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	An overview of the immigration of Albanians to the countries of the European Union: Legal immigration for reasons of work'	Bruksel, Belgjike	Konferencë shkencore: Thirty-fourth international conference on: "social and natural sciences – global challenge 2024" (icsns xxxiv-2024),		
7	Florida Arrinaj	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	'Legal and social changes in Europe-situation and perspectives'	Maqedoni e Veriut	5th International Scientific Conference on legal Sciences		
8	Florida Arrinaj	FD	Departamenti i të Drejtës Civile	'Understanding the vital role of family reunification in legal migration policies and its requirements'	Sokobanja Serbi	International Scientific Conference (44; 2024),		

UN
SHKODER
101



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"

15	Formimi profesional dhe shkencor i studentëve në fushën e ekonomisë dhe rritja e ndikimit të shkollës në aftësitë ekonomike dhe menaxheriale të tyre.	Përfshirjen e studentëve në dhënie e mendimeve për përmirësim e programeve të studimit dhe syllabuseve me ndikim në rritjen e formimit profesional të tyre në fushën ekonomike dhe menaxheriale	Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, I Administrim biznesit dhe turizmit	Realizuar plotësisht	Tetor 2023 - Shtator 2027
16	Përfshirja e studentëve në punën kërkimore rreth zhvillimeve ekonomike në rajon dhe më gjere dhe përgatitja e tyre për tregun e punës	Rritja e kërkesave për punën kërkimore - shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, nëpërmjet të hartimit të tezave të diplomës dhe projekteve në fushën ekonomike	Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit, I Administrim biznesit dhe turizmit	Realizuar plotësisht	Tetor 2023 - Shtator 2028

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

17	Niveli Bachelor Krijimi dhe zhvillimi i dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke formuar profesionistë të aftë për tregun e punës.	Përshtatja e planeve mësimore dhe programeve në përputhje me kërkesat e tregut të punës, për të qenë më atraktive për studentët	FSSH, Departamenti i Gjuhësisë, Letërsisë, Historisë, Gjeografisë	Plotësisht 100%	Tetor 2023 - Shtator 2024
